



Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës, në mbështetje të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës neni 26 (1) (1.1) dhe neni 43 (4), në mbledhjen e mbajtur me datë 21.12.2023, miraton:

### **UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 12/2023 PËR PËRJASHTIMIN E DOKUMENTACIONIT NË KONTROLLIN E PAPARALAJMËRUAR**

#### **Neni 1**

##### **Qëllimi**

Ky Udhëzim administrativ ka për qëllim të shpjegojë më në hollësi se cilat dokumente përjashtohen gjatë kontrollit paparalajmërim.

#### **Neni 2**

##### **Përkufizimet**

1. Për qëllimet e këtij Udhëzimi Administrativ shprehjet e mëposhtme kanë këtë kuptim:
  - 1.1. Autoriteti - Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovë.
  - 1.2. Klienti - ndërmarrja ose grupimi i ndërmarrjeve.
  - 1.3. Avokati - përfaqësuesi ligjor i ndërmarrjes ose i grupimit të ndërmarrjeve.

#### **Neni 3**

##### **Kontrolli pa paralajmërim**

1. Autoriteti mund të kontrollojë pa paralajmërim objektet e ndërmarrjes ose personit tjetër që i nënshtronhet hetimit, nëse ekziston rreziku se fshehin librat afarist ose dokumentet e tjera që kanë të bëjnë me procedurën që është duke u zhvilluar nga Autoriteti.
2. Autoriteti para se të kryejë kontrollin e paparalajmëruar, kërkon nga gjykata t'i autorizojë zyrtarët e Autoritetit të hyjnë pa paralajmërim ose leje të veçantë në objektin ku do të kryhet kontrolli.

#### **Neni 4**

##### **Përjashtimi i dokumenteve gjatë kontrollit pa paralajmërim**

1. Dokumentacioni që përjashtohet gjatë kontrollit të paparalajmëruar janë: letrat, shënimet dhe format e tjera të komunikimit mes ndërmarrjes ose grupimit të ndërmarrjeve ndaj të cilës zhvillohet procedura dhe avokatit të autorizuar të ndërmarrjes ose grupimit, të cilat quhen informata të fshehta ose konfidenciale.
2. Autoriteti mund të inspektojë dokumentet nëse ndërmarrja, grupimi i ndërmarrjes ose avokati i autorizuar refuzon t'i japë në shikim duke u thirrur në fshehtësi të informatave nga paragafi 1 i këtij neni.

3. Autoriteti nëse çmon se informata nuk është e fshehtë sipas paragrafit 1 të këtij nenit, zyrtari i autorizuar i Autoritetit e mbyll dokumentin ose kopjen e vërtetuar në zarf të posaçëm në praninë e përfaqësuesit ose avokatit të autorizuar të ndërmarrjes ose grupimit të ndërmarrjes.

4. Zarfi vuloset me vulë të Autoritetit, shënohet me datë dhe nënshkruhet nga zyrtari i autorizuar dhe të pranishmit.

### **Neni 5 Komunikimet e privilegjuara**

1. Autoriteti nuk lejohet të përdorë kompetencat e saj të hetimit për t'i kërkuar ndërmarrjes ose grupimit të ndërmarrjeve të zbulojë komunikimet e privilegjuara.

2. Komunikimet e privilegjuara përshtjnë:

2.1. Komunikimet ose pjesët e komunikimeve ndërmjet avokatit të ndërmarrjes ose grupimit të ndërmarrjeve për qëllime të dhënies ose marrjes së këshillave ligjore, ose kur ato bëhen në lidhje me shqyrtimin e procedurave ligjore dhe për qëllimet e këtyre procedurave.

2.2. Kjo, për shembull do të mbulonte një letër nga avokati i një kompanie drejtuar kompanisë tjetër, duke këshilluar nëse një marrëveshje e veçantë shkel ligjin.

### **Neni 6 Privilegji kundër vetë inkriminimit**

1. Autoriteti kërkon informacion ose shpjegime, por nuk mund të detyrojë një biznes të japë përgjigje me të cilën do të pohonte se ka shkelur ligjin.

2. Dokumente tashmë ekzistuese ose informacione që kanë të bëjnë me fakte të tillë si, nëse një punonjës i caktuar ka marrë pjesë në një takim të caktuar.

### **Neni 7 Plotësim ndryshimi**

Ndryshimi dhe plotësimi i këtij Udhëzimi Administrativ mund të propozohet nga çdo anëtarë i Komisionit, në mënyrën dhe procedurën e paraparë për miratimin e saj.

### **Neni 8 Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Kryetare e Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës



**Neime Binaku-Isufi**